

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit Ramiz Azizi, me sekretaren juridike Resmije Krasniqi, në lëndën penale ndaj të pandehurit L. S.nga f.M. shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.nr.27/16 të datës 29.01.2016, të cilën e përfaqësonte prokurorja Rozelida Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 18.08.2016,mori dhe publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I pandehuri **L. S.**nga babai **A.** dhe nëna **Z.**, e lindur **K.**, i lindur më ..., në **Z.**, e tani jeton në fshatin **M. k.e Gj.**, I martuar,babë i . fëmiu, ka të kryer shkollën e ..., i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Është fajtor

Sepse më datën ...2015, rreth orës ... minuta, në Gj., në rrugën “...” saktësisht përballë kafiterisë “...”, derisa i pandehuri ishte duke e drejtuar automjetin e markës “...” me targa të regjistrimit ..., pronë e NTSH “...” (renta-car), ka rrezikuar trafikun publik, duke i vu në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, në at mënyrë që me të arritur te kryqëzimi përballë kafiterisë “...”, duke mos e rrespektuar anën me përparësi kalimi, ndërron shiritin nga e djathta në të majtë, pa u vërtetuar se rrezikon anën e kundërt të lëvizjes, e në kundërshtim me nenin 62.1 të LSKRR, goditet nga automjeti i markës “...” me targa të regjistrimit ..., që qarkullonte nga drejtimi i kundërt në drejtim të Qendës së qytetit, të cilën e ka drejtuar i dëmtuari **A. K.** nga Gj., me që rast pos dëmeve materiale në të dyja automjetet, lëndime të lëhta trupore kanë pësuar **A. K.**, **N. S.**, **E. Sh.** dhe **B. S.**, të cilët për shkak të lëndimeve të pësuar, kanë qenë të detyruar që të kërkojnë ndihmë mjekësore në Qendrën Emërgjente në Gjilan, sipas raporteve mjekësore

me nr.25570,25563,25559 dhe 25560, të lëshuara nga Reparti i Kirurgjisë së Spitalit Regjional në Gjilan me datë 26.12.2015.

-me çka ka kryer veprën penale,rrezikim i trafikut publik,nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së

Andaj konform nenit te lartcekur si dhe te neneve 4,17,23,49,50,51,52 dhe 73 te KPRK-se si dhe te neneve 365,451 dhe 463 te KPPRK-së,të akuzuarit ia shqipton

DËNIM ME KUSHT

*Ashtu që të pandehurit A. G. i caktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej **180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve**, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë nëse në afat prej **1 (një) viti** nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.*

Të dëmtuarit A.K., N. S., E. Sh. e B. S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e ekspertizave mjekësore në shumë prej 50 Eurove, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të pandehurit L. S.nga f.M. , për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prokurorja e shtetitRozelida Hasani, në seancën e sodit fillestare, pos tjerash, në fajlën e saj përfundimtare, pasi që i pandehuri e pranoi fajësinë, kërkoj që atij ti shqiptohet një dënim meritore dhe i bazuar në ligj.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës së lartcekur i pandehuri L. S.ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, duke shtuar se më vjen keq për rastin e ndodhur, ndërsa gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen do të jetë shumë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të ShtetitArben Ismajli dhe të pandehurit L. S., konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri L. S.nga fshati M., nga pakujdesia ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit A. G., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas neneve 73 dhe 74 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljen shumë të mirë të tij gjatë shqyrtimit fillestar, se i pandehuri ka shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, si dhe faktin se i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë drejtimit të automjetit.Poashtu ai erdhi dhe para kohe iu lajmërua vet gjyqtarit për në shqyrtim gjyqësor. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese, pos dëmeve të shkaktuara të dëmtuarve të lartcekur.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht, ndaj të pandehurit L. S.është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e

përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, kurse vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
Më 183.08.2016

Sekretarja juridike,
Resmije Krasniqi

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*